



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**PROGRAMI I STUDIMIT DOKTORATË NË FUSHËN SHKENCA HUMANE ME NËNFUSHË “SHKENCA GJUHËSORE” DHE “LETËRSIA BOTËRORE MODERNE DHE POSTMODERNE”**

**NËNFUSHA SHKENCA GJUHËSORE NË KËTO DREJTIME KRYESORE:**

1. “GJUHËSI E ZBATUAR DHE KRAHASUESE”
2. “MËSIMDHËNIE E GJUHËS SË HUAJ”
3. “STUDIME PËRKTHIMORE DHE TË INTERPRETIMIT”
4. “GJUHËSI KOMPJUTERIKE E ZBATUAR”
5. “KOMUNIKIM NDËRKULTUROR”

**Nënfusha kryesore e kërkimit: “SHKENCA GJUHËSORE”**

**✓ Drejtimi kryesor: “GJUHËSI E ZBATUAR DHE KRAHASUESE”**

**Projektet kërkimore sipas departamenteve:**

➤ **Departamenti i gjuhës Angleze:**

1. Krahasimi i dukurive gjuhësore në shqipe dhe anglisht

**Objektivat:**

- a. Paraqitja e dallimeve midis dukurive të caktuara gjuhësore në gjuhën angleze dhe shqipe.
- b. Paraqitja e ngjashmërive midis dukurive të caktuara gjuhësore në gjuhën angleze dhe shqipe.
- c. Ndërthurja e dallimeve dhe ngjashmërive.
- d. Analizë e dallimeve dhe ngjashmërive për të trajtuar efektet didaktike gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies të gjuhës angleze si gjuhë e huaj.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës; grupi kërkimor – mësimor i Gjuhësisë

**2. Gjuhësia e zbatuar në edukim**

**Objektivat:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- a. Trajtimi i aspekteve gjuhësore në kuadrin aplikativ.
- b. Lidhja e gjuhësisë së zbatuar me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- c. Studimi i aspekteve të gjuhësisë së zbatuar në kontekstin e fonetikës dhe fonologjisë, leksikut, morfologjisë, sintaksës, etj.
- d. Trajtimi i metodave dhe teorive gjuhësore dhe zbatimi i tyre në gjuhën angleze dhe shqipe.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës; grupi kërkimor – mësimor i Gjuhësisë

**3. Përvetësimi i aspekteve të ndryshme gjuhësore nga grupmosha të ndryshme.** Faktorët dhe qasjet kryesore që kontribojnë në përvetësimin e tyre.

**Objektivat:**

- a) Identifikimi i faktorëve që ndikojnë ndjeshëm në përvetësimin e një gjuhe të dytë ose të tretë në popullata të ndryshme nxënësish.
- b) Përcaktimi se si variablat sociokulturor dhe njohës ndikojnë në përvetësimin e gjuhës. Analiza e cilësisë në mësimin efektiv të gjuhës.
- c) Hetimi i proceseve të përvetësimit të gjuhës së dytë (SLA) në të gjitha grupmoshat.
- d) Analiza e rolit që luan gjuha amtare në përvetësimin e gjuhës së dytë. Shqyrtim i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë, duke përfshirë aspektet njohëse dhe përpunimin e gjuhës.
- e) Studimi i efektivitetit të metodave të ndryshme pedagogjike (p.sh., immersion, mësimi i qartë i gramatikës) në përvetësimin e gjuhës.
- f) Shqyrtim i ndikimit të mjeteve dixhitale dhe AI në përvetësimin e gjuhës në mjediset arsimore.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës; grupi kërkimor – mësimor i Gjuhësisë

**4. Edukimi gjuhësor.** Vlerësimi dhe implementimi i strategjive efektive në kontribut të krijimit të pedagogjisë kritike për promovimin e aftësisë gjuhësore në kontekste të ndryshme arsimore.

**Objektivat:**

1. Shqyrtimi i efektivitetit të strategjive të mësimdhënies në promovimin e aftësisë gjuhësore.
2. Vlerësimi i metodologjive të ndryshme të mësimdhënies në nxitjen e zhvillimit gjuhësor midis popullatave të ndryshme studentore. Ndikimi i pedagogjisë kritike në riformësimin e edukimit gjuhësor për të qenë më gjithëpërfshirës dhe më i barabartë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

3. Krahasimi i edukimit tradicional gjuhësor të bazuar në klasë me modelet e të mësuarit dixhital ose të përzier. Shqyrtimi i integritetit të teknologjive dixhitale në edukimin gjuhësor dhe ndikimin e tyre në rezultatet e të nxënësve.
4. Shqyrtim i ndikimit të programeve të trajnimit të mësuesve në cilësinë e mësimdhënies gjuhësore.
5. Studimi i edukimit gjuhësor në klasa shumëgjuhëshe. Zhvillimi i një kornize për mësimin efektiv të gjuhës në kontekste arsimore shumëgjuhëshe dhe multikulturore.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës; grupi kërkimor – mësimor i Gjuhësisë

**5. Vlerësimi i aftësive gjuhësore.** Hetimi i metodave të ndryshme të vlerësimit dhe analizimi i ndikimit të formateve të vlerësimit për të zhvilluar strategji dhe formate vlerësuese të besueshme, të vlefshme dhe të drejta.

**Objektivat:**

- a) Zhvillimi i vlerësimeve të besueshme, të vlefshme dhe të drejta të aftësive gjuhësore. Analizimi i ndikimit të formateve të vlerësimit (psh, me zgjedhje të shumëfishta kundrejt përfundimit të hapur) në performancën e nxënësve.
- b) Analizimi i rolit të vlerësimeve formuese dhe përmbledhëse në përparimin e mësimin të gjuhës.
- c) Hetimi i mënyrës se si vlerësimet e gjuhës së bazuar në teknologji krahasohen me testet tradicionale të bazuara në letër.
- d) Studimi i ndikimit të testeve të gjuhës me nivele të larta (psh. TOEFL, IELTS) në hartimin e kurrikulës dhe sjelljet e të nxënësve të studentëve.
- e) Hartimi dhe zbatimi i qasjeve dhe instrumenteve të reja të vlerësimit për nxënësit në nivele të ndryshme të aftësisë gjuhësore.
- f) Të kuptuarit e implikimeve dhe metodave të ndryshme të vlerësimit në angazhimin e studentëve dhe rezultatet e të nxënësve.
- g) Analizimi i efekteve të kthimit të testeve të gjuhës në mësimdhënie dhe praktikën e kurrikulës.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës; grupi kërkimor – mësimor i Gjuhësisë

**6. Krijimi i korpuseve gjuhësore për qëllime në mësimdhënie dhe ndikimi i tij në procesin e të nxënësve të gjuhës së huaj.**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**Objektivat:**

- a) Ndërtimi dhe analizimi i korpuseve për qëllime të mësimdhënies dhe vlerësimit të gjuhës. Krijimi i një korpusi të nxënësit për ekzaminimin e modeleve dhe gabimeve të përvetësimit të gjuhës.
- b) Hulumtimi i modeleve leksikore dhe sintaksore në gjuhën e nxënësit nëpërmjet të dhënave të korpusit. Analizimi i modeleve gjuhësore në përdorimin e gjuhës autentike në zhanre dhe regjistra të ndryshëm. Studimi i variacionit gjuhësor, dialektologjisë dhe ndryshimit të gjuhës përmes analizës së korpusit.
- c) Zhvillimi i qasjeve të bazuara në të dhëna nga korpusi për mësimin e gjuhës. Eksplorimi i përdorimit të korpuseve në identifikimin e niveleve të aftësisë gjuhësore dhe gjurmimin e përparimit të nxënësve.
- d) Përdorimi i të dhënave të korpusit për të zhvilluar materiale mësimore gjuhësore ose për të përmirësuar përshkruesit e aftësisë gjuhësore.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës; grupi kërkimor – mësimor i Gjuhësisë

7. Zbatimi i modeleve të këmbimit të gjuhës (code-switching) tek nxënësit me programe mësimore në gjuhë të huaj.

**Objektivat:**

- a) Identifikimi i modeleve gjuhësore të ndërrimit të gjuhës në varësi të kontekstit, audiencës dhe kufizimeve gjuhësore.
- b) Identifikimi i situatave dhe faktorëve që ndikojnë në ndërrimin e gjuhës (si niveli i njohjes së gjuhës, temat mësimore ose presioni social)
- c) Hartimi i strategjive dhe metoda të reja mësimore që përdorin ndërrimin e gjuhës si një mjet për të përmirësuar aftësitë e të nxënësit dhe të kuptuarit të nxënësve në gjuhët e huaja
- d) Hulumtimi i këndvështrimeve mbi dukurinë e ndërrimit të gjuhës si një praktikë që ndihmon apo pengon në përvetësimin e gjuhës së huaj.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës; grupi kërkimor – mësimor i Gjuhësisë

➤ **Departamenti i gjuhës Italiane ka këto projekte kërkimore:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

1. Dukuri të ndryshme në planin gjuhësor dhe respektivisht në atë të leksikologjisë, leksikografisë dhe semantikës italiane krahasuar në italisht dhe në shqip

**Objektivat:**

- a. Shpjegimi i fenomeneve të ndryshme në planin gjuhësor dhe specifikisht në atë leksikologjik, leksikografik dhe semantik si në gjuhën italiane edhe në atë shqipe.
- b. Fenomene të caktuara leksiko-semantike në kuadrin e gjuhës italiane dhe atë shqipe si nga pikëpamja e ngjashmërive ashtu edhe të ndryshimeve.
- c. Analiza sasiore e këtyre aspekteve leksiko-semantike të para në plan përqasës dhe veçoritë e tyre. Marrja e këtyre vlerave gjuhësore si dobi në proceset didaktike të mësimdhënies së gjuhës së huaj.

➤ **Departamenti i gjuhëve Sllave dhe Ballkanike ka këto projekte kërkimore:**

1. Gjuhësi Ballkanike

**Objektivat:**

- a. Të studiohen në rrafshin sinkronik çështjet e përshkruara në qëllimin e këtij drejtimi kërkimor.
- b. Të studiohen në rrafshin diakronik çështjet e përshkruara në qëllimin e këtij drejtimi kërkimor.
- c. Të analizohet marrëdhënia gjuhë/kulturë.
- d. Të krijohet mundësia për zhvillimin e projekteve rajonale ballkanike që të kenë në fokus bashkëpunimin e doktorantëve në këtë drejtim kërkimor.

2. Gjuhësi e zbatuar në mesimdhënien e gjuhës së huaj

**Objektivat:**

- a. Të studiohen metoda të ndryshme për mesimdhënien e gjuhës së huaj.
- b. Të studiohen aftësitë e të folurit, të shkruarit, të leximit dhe të dëgjimit në përputhje me Kuadrin Europian të Gjuhëve.
- c. Të evidentohen problematika në mesimdhënien e gjuhës së huaj.

3. Psikolinguistika



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**Objektivat:**

- a. Të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve që shfaqen në të folur tek fëmijët e grup moshave të ndryshme.
  - b. Të nxisë aftësitë hulumtuese dhe analitike të studiuesve të rinj për të studiuar dhe evidentuar problematikat në këtë fushë.
  - c. Të rrisë aftësitë e stafit akademik për të udhëhequr projekte në këtë drejtim/fushë.
  - d. Të kontribuojë në nxitjen e kapaciteteve analitike dhe krahasimore të doktorantëve si dhe në dhënien e sugjerimeve konkrete për kapërcimin e vështirësive që shfaqen tek fëmijët e grupmoshave të ndryshme.
4. Antropologjia gjuhësore

**Objektivat:**

- a. Aspekte studimore në lidhje me fushën e antropologjisë gjuhësore.
- b. Metoda të përdorura në analizën e çështjeve të antropologjisë gjuhësore.

5. Sociolinguistika

**Objektivat:**

- a. Të studiohen varietetet e gjuhëve sipas grupeve të ndara sipas moshës, gjinisë, nivelit arsimor, përkatësisë etnike, fesë, etj.
- b. Të studiohen konceptet themelore të sociolinguistikës.
- c. Të studiohen socioletet, gramatika, fjalori dhe aspekte të tjera të socilekteve.
- d. Të studiojë variablat sociolinguistikë.
- e. Të studiohen kompetencat gjuhësore, ekstragjuhësore, transferuese, instrumentale, strategjike që duhet të ketë përkthyesi dhe interpreti, si dhe çështje të etikës profesionale.

6. Terminologjia në rrafshin përqasës me një gjuhë tjetër

**Objektivat:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- a. Të studiojë konkretisht terminologjinë në një fushë të caktuar.
  - b. Të ndihmojë në evidentimin e termave të reja të ndikuara nga zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe shkencës.
  - c. Të nxisë aftësitë hulumtuese dhe analitike të studiuesve të rinj mbi punime konkrete me korpusin terminologjik.
7. Semantika në rrafshin përqasës me një gjuhë tjetër

**Objektivat:**

- a. Të studiojë strukturat e shprehjeve frazeologjike dhe fjalëve të urta.
  - b. Të studiojë gjendjen e sotme të pasurisë leksikore të gjuhës turke.
  - c. Të punojë mbi një material të përzgjedhur nga gjuhët e përmendura më sipër.
  - d. Të punojë konkretisht me fjalorë frazeologjikë të gjuhës turke, ruse, greke, të gjuhëve ballkanike.
8. Krahasimi i dukurive gramatikore të shqipes dhe rusishtes

**Objektivat:**

- a. Gjetja dhe ballafaqimi i dukurive gramatikore të përbashkëta midis gjuhëve.
- b. Analizë diakronike dhe sinkronike këtyre dukurive.
- c. Përdorimi me efikasitet i pikëtakimeve dhe i dallimeve gjuhësore midis gjuhëve, në funksion të përkthimit nga gjuha ruse dhe anasjelltas, si edhe mësimdhënies së gjuhës ruse si e huaj

**Departamenti i Gjuhës Gjermane ka këto projekte kërkimore:**

1. Hulumtimi i dallimeve dhe ngjashmërive gjuhësore mes gjermanishtes dhe shqipes në disiplinat kryesore të gjuhësisë

**Objektivat:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- a) Paraqitja e dallimeve dhe ngjashmërive midis dukurive të caktuara gjuhësore në gjuhët shqipe dhe gjermane.
- b) Analiza e dallimeve dhe ngjashmërive si edhe evidentimi i tipareve universale të dukurive gjuhësore
- c) Trajtimi i dallimeve dhe ngjashmërive mes këtyre dy gjuhëve me fokus të vecantë qasjet didaktike në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjermanishtes në kontekstin shqiptar e më gjerë.
- d) Studimi i fenomeneve gjuhësore në rrafshin sinkronik dhe diakronik dhe plotësimi i boshllëqeve aktuale në kërkimin dhe studimet shkencore kontrastive mes shqipes e gjermanishtes në të gjitha disiplinat e ndryshme të gjuhësisë (fonetikë, morfologji, sintaksë, leksikologji, frazeologji, pragmatikë, gjuhësi konjitive etj.).
- e) Lidhja gjuhë-kulturë.
- f) Hulumtimi i thelluar i dukurive gjuhësore në frymën e teorive bashkëkohore të shkencës së gjuhësisë
- g) Lidhja e gjuhësisë së zbatuar me procesin e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj.

➤ **Departamenti i gjuhës Greke ka këto projekte kërkimore:**

- 1. Qasje strategjike dhe metodologjike të përvetësimit të leksikut në studentë të gjuhës greke në një kontekst dominues shqiptar

**Objektivat:**

- a. Studimi i strategjive dhe metodologjive të adoptuara nga studentët e gjuhës greke në përvetësimin e leksikut të gjuhës greke në vendin tonë për qëllime studimore e profesionale.
- b. Studimi i nevojave gjuhësore/ leksikore të studentëve në fushën metodologjike dhe strategjive të përvetësimit të fjalorëve.
- c. Të ndihmojë në përfitim të kompetencave gjuhësore/ leksikore e kulturore e komunikative të studentëve.
- d. Të ndihmojë në përdorimin e qasjes vepruese në metodologjitë dhe strategjitë e përvetësimit të leksikut, çka e bën studentin përdorues aktiv të gjuhës dhe nxit autonominë e të nxënit.
- e. Ndihmon në zbatimin e një metodologjie vlerësimi transparente dhe objektive të kompetencave të studentëve si edhe nxit vetëvlerësimin dhe autonominë e të nxënit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- f. Ndhmon në përdorimin e kriterëve transparente dhe objektive në vlerësimin e aftësive të mësuesve dhe kualifikimin e tyre.
- g. Ndhmon në konceptimin e materialeve leksikologjike e pedagogjike në përputhje me qëllimet dhe kriteret e kërkimit.

➤ **Departamenti i gjuhës Frënge ka këto projekte kërkimore:**

- 1. Analiza Gjuhësore dhe Dokumentimi i Gjuhës së Shenjave Shqipe

**Objektivat:**

- a. Të identifikohet dhe klasifikohet struktura morfologjike e GJSHSh
- b. Studimi i mënyrës se si formohen fjalët dhe shenjat në këtë gjuhë
- c. Të analizohen strukturat sintaksore të GJSHSh
- d. Të vëzhgohet rendi i fjalëve, marrëdhëniet ndërmjet pjesëve të fjalisë (si subjekt-predikat-objekt) dhe mënyra e ndërtimit të pyetjeve apo mohimeve.
- e. Të hulumtohet sistemi semantik dhe ikonik i GJSHSh
- f. Si paraqiten konceptet dhe kuptimet përmes ikonizmit (përfaqësimi vizual i kuptimit) dhe metaforës vizuale.
- g. Të studiohen funksionet pragmatike të shenjave në kontekste të ndryshme. Si ndikohet përdorimi i shenjave nga situata komunikative, emocionale dhe kulturore.
- h. Të identifikohen ngjashmëritë dhe dallimet me gjuhët e tjera të shenjave
- i. Të kontribuohet në ndërtimin e një gramatike deskriptive të GJSHSh
- j. Të përgatitet një dokument akademik që përshkruan rregullat bazë të funksionimit të kësaj gjuhe në mënyrë të kuptueshme për studiues dhe praktikues.

✓ **Drejtimi kërkimor: “MËSIMDHËNIE E GJUHËS SË HUAJ”**

**Projektet kërkimore sipas departamenteve:**

➤ **Departamenti i gjuhës Angleze:**

- 1. Mësimdhënia e leximit në anglisht në shkollën shqiptare: përvoja dhe sfida

**Objektivat:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- a) Studentët të pajisen me njohuri të thelluara teorike dhe me aftësi të larta kritike, që demonstrohen me njohje të mirë të literaturës që lidhet me fushën e studimit, të teorive dhe qasjeve të ndryshme, të praktikave si dhe paradigmave të kërkimit kritik në fushë;
- b) Të zhvillojnë ekspertizë në fushën e mësimdhënies dhe nxënies së anglishtes si gjuhë e huaj, që demonstron me zotërimin e koncepteve, teorive dhe kërkimeve, dhe të kuptuarit e praktikave dhe konteksteve perkatëse arsimore të nevojshme për të analizuar në mënyrë kritike dhe për të ngritur pyetje përtej shkallës së njohjes, me synim zhvillimin dhe përmirësimin e përvojave ekzistuese.
- c) Të përftojë kompetenca më të zhvilluara në zhvillimin dhe vlerësimin e kurrikulës së gjuhës së huaja, si dhe të thellojë e rrisë kuptimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies,
- d) Të krijojë dhe zhvillojë qasje të përparuara kërkimore, kompetenca që përfshijnë paraqitjen e problemeve kërkimore që bazohen në teoritë, kërkimet dhe praktikën në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja, si dhe përcaktimin e metodologjisë të pershtatshme dhe zgjedhjen e metodave të kërkimit respektive për problemet kërkimore të shtruara.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës

**2. Mësimdhënia e integruar e gjuhës së huaj bazuar në harmonizimin e metodave tradicionale me ato bashkëkohore: sfidat në kontekstin shqiptar**

**Objektivat:**

- a) Ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e një qasjeje të integruar në mësimdhënie;
- b) Përditësimi me rezultatet e kërkimit shkencor në fushën e metodologjisë së mësimit të gjuhës së huaj veçanërisht me metodat më efektive në mësimdhënie;
- c) Aftësimi për të vlerësuar saktë metodat dhe praktikën më pozitive në mësimdhënien e gjuhës së huaj;
- d) Aplikimi me sukses i qasjeve/metodave/praktikave më pozitive në kontekstin shqiptar;

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**3.**Integrimi i teknologjisë dhe aftësive të inovacionit (mendimi kritik, komunikimi, bashkëpunimi dhe kreativiteti) në mësimdhënien e gjuhës së huaj krahas zhvillimit të aftësive bazë (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit)

**Objektivat:**

- a) Njohja me burime të ndryshme të teknologjisë së informacionit dhe aftësimi për t'i integruar ato në mësimdhënien e gjuhës së huaj;
- b) Të kuptuarit e aftësive të inovacionit të njohura ndryshe edhe si aftësitë e shekullit të 21-të.
- c) Integrimi i aftësive të inovacionit në mësimdhënie krahas zhvillimit të atyre bazë;
- d) Ngritja e nivelit të mësimdhënies së gjuhës së huaj në lartësinë e kërkesave të kohës;
- e) Ndikimi i teknologjive të reja (inteligjenca artificiale dhe realiteti i shtuar) në krijimin e realiteteve dhe konteksteve për praktikimin e gjuhës, si përdorimi i chatbot-eve apo programeve të realitetit të shtuar për simulimin e situatave reale.
- f) Eksplorimi i rolit të mediave sociale, si Facebook, Instagram, YouTube, dhe Twitter, në përvetësimin dhe praktikimin e gjuhës përmes ndërveprimit me përmbajtjeve autentike.
- g) Analizimi i efektit të lojërave digjitale në nxitjen e motivimit dhe përvetësimin të gjuhës së huaj.
- h) Vlerësimi i sfidave teknologjike dhe infrastrukturore në integrimin e TIK në klasën e gjuhës së huaj
- i) Studimi i ndikimit të teknologjive të komunikimit sinkron dhe asinkron në mësimdhënien e gjuhës së huaj
- j) Hulumtimi i ndikimit të burimeve të hapura arsimore (Open Educational Resources - OER) në mësimin e gjuhëve të huaja
- k) Eksplorimi i teknologjive të reja të vlerësimit për mësimdhënien e gjuhëve të huaja
- l) Hulumtimi i ndikimit të teknologjisë në zhvillimin e autonomisë së nxënësve në procesin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Didaktikës dhe Metodikës

**4.** Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve të gjuhës së huaj. Krahasimi i modeleve të ndryshme të zhvillimit profesional dhe ndikimi i tyre në cilësinë e mësimdhënies.

**Objektivat:**

- a) Informimi i mësuesve të gjuhës së huaj me qasjet dhe metodat e reja në mësimdhënie;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- b) Zhvillimi i aftësive dhe strategjive të reja për një mësimdhënie më efektive;
- c) Përgatitja e mësuesve të gjuhës së huaj të aftë për të përballuar sfidat që paraqet konteksti i ri i të nxënit;
- d) Promovimi i programeve dhe praktikave që ndikojnë në rritjen e cilësisë së mesimdhënies;
- e) Vlerësimi i rolit të TIK në përmirësimin e formimit profesional të mësuesve të gjuhëve të huaja;
- f) Hulumtimi i përvojave dhe qëndrimeve të mësuesve ndaj përdorimit të TIK në procesin mësimor:

➤ **Departamenti i gjuhës Frënge ka këto projekte kërkimore:**

1. Qasje didaktike e metodologjike ndërkulturore e veprues në mësimdhënien/nxënien dhe formimin e mësuesve të gjuhëve të huaja dhe vlerësimi i kompetencave sipas standardeve evropiane

**Objektivat:**

- a. Krijimin e një panorame të qartë e të hollësishme të mësimdhënies/nxënies së gjuhëve të huaja në vendin tonë për qëllime studimore e profesionale.
  - b. Studimi i nevojave gjuhësore të studentëve, të mësuesve dhe të nxënësve në fushën metodologjike dhe strategjive të mësimdhënies/nxënies.
  - c. Të ndihmojë në përfitim të kompetencave gjuhësore e kulturore e komunikative të nxënësve e studentëve.
  - d. Të ndihmojë në përdorimin e qasjes vepruese në mësimdhënie e cila e bën nxënësin e studentin përdorues aktiv të gjuhës dhe nxit autonominë e të nxënit.
  - e. Ndhmon në zbatimin e një metodologjie vlerësimi transparente dhe objektive të kompetencave të nxënësve dhe studentëve si edhe nxit vetëvlerësimin dhe autonominë e të nxënit.
  - f. Ndhmon në përdorimin e kriterëve transparente dhe objektive në vlerësimin e aftësive të mësuesve dhe kualifikimin e tyre.
  - g. Ndhmon në konceptimin e materialeve pedagogjike dhe konceptimit të sekuencave didaktike në përputhje me qëllimet dhe kriteret e kërkimit.
2. Integrimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në klasën e gjuhës së huaj dhe në formimin e mësuesve



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**Objektivat:**

- a. Të krijojë një panoramë të përgjithshme mbi situatën aktuale të përdorimit të teknologjive në mësimdhënien/mësimnxënien e gjuhës së huaj në vendin tone.
  - b. Të nxjerrë në pah nevojat e mësuesve dhe nxënësve në fushën e përdorimit të TIK-ut në klasën e gjuhës së huaj.
  - c. Të ndihmojë në zhvillimin e kulturës dixhitale, njohjen dhe përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
  - d. Të ndihmojë mësuesit dhe nxënësit në integrimin e TIK-ut në praktikën e tyre pedagogjike.
  - e. Të studiojë mënyrën se si teknologjitë mund të zhvillojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien e aftësive gjuhësore dhe kulturore.
  - f. Të ndihmojë në përvetësimin dhe integrimin e kuadrit të referencave për zhvillimin e aftësive TIK në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhëve të huaja
3. Ndërveprimi ndërmjet përkthimit automatik dhe didaktikës së gjuhëve për qëllime specifike /Përkthimi automatik dhe përdorimi i tij në mësimdhënien e gjuhëve për qëllime specifike (GJQS)

**Objektivat:**

- a. Analiza e mënyrave më efektive për të integruar përkthimin automatik në orën mësimore të GJQS.
- b. Vlerësimi i cilësisë së përkthimeve automatike në fusha të ndryshme terminologjike (ligjore, ekonomike).
- c. Ndërtimi i praktikave didaktike që kombinojnë PA me post-editim dhe analizë krahasuese ndërgjuhësore.
- d. Zhvillimi i një qasjeje të bazuar në detyra që nxit mendimin kritik dhe ndërgjegjësimin metagjuhësor te studentët.

➤ **Departamenti i gjuhës Italiane ka këto projekte kërkimore:**

1. Aspekte të kërkimit shkencor në mësimdhënien /mësimnxënien e gjuhës italiane si gjuhë e huaj në kontekstin shqiptar



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**Objektivat:**

- a. Zhvillimin e kompetencave hulumtuese të studentit doktorant në lëmin e arsimit me fokus mësimdhënien dhe gjithçka përfshin ajo.
- b. Zhvillimin e thelluar të njohurive lidhur me metodat, qasjet, metodologjitë e mësimdhënies së gjuhës së huaj, përjasjen dhe analizimin e tyre.
- c. Zhvillimin e njohurive të thelluara teorike dhe zhvillimin e mendimit kritik me qëllim analizimin, përjasjen dhe nxjerrjen e të dhënave sasiore dhe cilësore në lidhje me to.
- d. Zhvillimin e aftësive analitike lidhur me çështje që kanë të bëjnë me aspekte të mësimdhënies/ nxënies të gjuhës italiane.
- e. Zhvillimin e kompetencave diagnostikuese të problematikave në terren, analizimi dhe ofrimin e zgjidhjeve të mundshme.
- f. Zhvillimin e kompetencave në vlerësimin e kurrikulave të gjuhës italiane.
- g. Zhvillimin e kompetencave në mësimdhënien/ mësimnxënien e aftësive parësore dhe të integruara të gjuhës së huaj.
- h. Zhvillimin e kompetencave në vlerësimin e përvetësimit të gjuhës italiane.
- i. Zhvillimin e kompetencave në hartimin e testeve të vlerësimit të gjuhës italiane.
- j. Zhvillimin e kompetencave në vlerësimin e teksteve dhe materialeve didaktike të gjuhës italiane.
- k. Zhvillimin e kompetencave në mësimdhënie me fokus studentin.
- l. Zhvillimin e kompetencave menaxhuese të orës mësimore.
- m. Zhvillimin e kompetencave formuese ndërkulturore dhe të qytetërimit me fokus përjasjen e kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme, didaktikën e tyre në kuadrin e mësimdhënies të gjuhës italiane.
- n. Zhvillimin e kompetencave në përdorimin e teknologjive në mësimdhënien e gjuhës italiane.

➤ **Departamenti i gjuhës Gjermane këto projekte kërkimore:**

1. Përvetësimi i gjuhës gjermane me fokus në kompetencat dhe shprehitë gjuhësore. Konsiderata metodologjike dhe didaktike mbi vlerësimin e aftësive gjuhësore në gjermanisht (fokusi kompetenca e të shkruarit dhe të folurit)

**Objektivat:**

- a. Transmetimi i strategjive efektive, specifike në lidhje me kompetencat e të shkruarit dhe të folurit duke marrë parasysh dhe njohuritë e mëparshme dhe nevojat mësimore të nxënësve



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- b. Individualizimi dhe diferencimi i detyrave të ndryshme në lidhje me këto kompetenca sipas fokus-grupeve.
- c. Analizë e përzgjedhjes së materialit mësimor për të rritur motivimin dhe interesin në të nxënë.
- d. Analizë e teknikave të tilla si sjellja model, vetë-udhëzimi, praktika e udhëhequr dhe e pavarur.
- e. Evidentimi dhe raportimi në mënyrë të vazhdueshme i progresit individual në zotërimin e dy strategjive.
- f. Demonstrimi i strategjive të reja dhe zbatimi në praktikë në kuadër të ndryshimit të kërkesave dhe sfidave të reja në arsim.
- g. Analizë e interferencës gjuhësore të gjuhës mëmë për të kuptuar vështirësitë në këto dy kompetenca.
- h. Konstatimi i rolit të mësuesit në realizimin e suksesshëm të këtyre dy kompetencave.

**✓ DREJTIMI KËRKIMOR: “ GJUHËSI KOMPJUTERIKE E ZBATUAR”**

**Projekti kërkimor sipas departamenteve:**

**Departamenti i gjuhës Angleze ka këto projekte kërkimore:**

**1. Trajtimi automatik i gjuhës për qëllime specifike**

**Objektivat**

- a) Hulumtimi i teorive dhe metodologjive ekzistuese në trajtimin automatik të gjuhës (NLP)
- b) Zhvillimi i një modeli të avancuar për njohjen e qëllimeve specifike: Të krijohet dhe testohen një model i mësimin të makinerive (machine learning) për identifikimin dhe analizimin e qëllimeve specifike në tekst, duke përdorur të dhëna të ndryshme.
- c) Analiza e përdorimit të qëllimeve specifike në kontekste të ndryshme: Të shqyrtohen rastet e përdorimit të qëllimeve specifike në fusha të ndryshme si medicina, teknologjia, ligji, etj., për të identifikuar nevojat dhe kërkesat për trajtim automatik.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- d) Zhvillimi i metodave që lejojnë personalizimin e trajtimit të qëllimeve specifike në varësi të nevojave të përdoruesve dhe konteksteve të ndryshme.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Gjuhësisë

**2. Krijimi i një Korpusi Paralel për zhvillimin e materiale didaktike për mësimin e gjuhës së huaj**

**Objektivat:**

- a) Përpilimi i një korpusi paralel i krijuar posaçërisht për mësimin e gjuhës, duke përfshirë tekste mësimore për nxënës të mësojnë gjuhën shqipe dhe anglishten.
- b) Mbledhja dhe përafrimi i materialeve mësimore, siç janë tekstet shkollore, ushtrimet gjuhësore dhe tekstet e leximit në gjuhën shqipe dhe anglisht.
- c) Përfshirja e shembujve të përdorimit të përditshëm të gjuhës, shprehjeve frazeologjike, proverbeve dhe leksikut me ngjyrimet kulturore për të pasuruar përvetësimin e gjuhës.
- d) Zhvillimi i mjeteve didaktike në të dy gjuhët, që përdorin korpusin paralel për ushtrime ndërvepruese, ndërtimin e fjalorit dhe përmirësimin e gramatikës.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Gjuhësisë

➤ **Departamenti i gjuhës Frënge ka këto projekte kërkimore:**

1. Trajtimi automatik i gjuhës për qëllime specifike.

**Objektivat:**

- i. Vlerësimin e saktë dhe të plotë të nevojave për programe ndërdisiplinare për t'i pajisur studentët me kompetenca (aftësi) gjuhësore dhe informatike duke favorizuar punësimin e tyre në tregun lokal dhe europian.
- j. Formimin e specializuar sikurse është trajtimi automatik i gjuhëve.
- k. Rikonceptimin e metodave të mësimdhënies bazuar në dimension digjital.
- l. Krijimin e burimeve të përbashkëta dhe të përshtatshme për formimin e përkthyesve me mjete informatike duke u fokusuar në përmbytjen elektronike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- m. Krijimin e korpuseve shumëgjuhëshe
2. Mësimdhënia e gjuhëve të huaja të asistuar nga kompjuteri.

**Objektivat:**

- a. Krijimi i platformave/programimeve/mjeteve për krijimin e përmbajtjeve tekstore.
  - b. Deep learning për të klasifikuar, njohur, lokalizuar dhe përshkruar informacionin gjuhësor në funksion të qëllimeve të ndryshme.
  - c. Analizë semantike dhe sintaksore nëpërmjet trajtimit automatik të gjuhëve.
3. Trajtimi automatik i gjuhës / Përpunimi semantik i dokumenteve të shkruara (tekste ligjore, ekonomike, etj.)

*Objektivat:*

- a. Zhvillimi i një sistemi për analizën semantike të dokumenteve ligjore/ekonomike.
  - b. Ekstraktimi automatik i **entitete** (persona, data, institucione, numra, ligje).
  - c. Ndërtimi i modeleve për **marrëdhënie semantike** midis këtyre entiteteve (p.sh. kush i kërkon çfarë kujt, sipas cilës ligj, në çfarë date).
4. Tema: Trajtimi automatik i gjuhës/ Përkthim automatik i gjuhëve me burime të kufizuara “low resources language”

*Objektivat:*

- a. Zhvillimi i një sistemi për përkthimin automatik të saktë dhe të rrjedhshëm për një ose më shumë gjuhë low-resource.
- b. Ndërtimi i korpuseve dygjuhëshe
- c. Zhvillimi i metodave efikase për përmirësimin e cilësisë së përkthimit në mungesë të të dhënave të mjaftueshme.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

***5. Ndërveprimi ndërmjet përkthimit automatik dhe didaktikës së gjuhëve për qëllime specifike/ Përkthimi automatik dhe përdorimi i tij në mësimdhënien e gjuhëve për qëllime specifike (GJQS)***

- a. Analiza e mënyrave më efikase për të integruar përkthimin automatik në orën mësimore të GJQS.
- b. Vlerësimi i cilësisë së përkthimeve automatike në fusha të ndryshme terminologjike (ligjore, ekonomike).
- c. Ndërtimi i praktikave didaktike që kombinojnë PA me post-editim dhe analizë krahasuese ndërgjuhësore
- d. Zhvillimi i një qasjeje të bazuar në detyra që nxit mendimin kritik dhe ndërgjegjësimin metagjuhësor te studentët

**✓ DREJTIMI KËRKIMOR: “KOMUNIKIM NDËRKULTUROR”**

**Projekti kërkimor sipas departamenteve:**

- **Departamenti i gjuhës Angleze ka këto projekte kërkimore:**

**Drejtimi kërkimor – Komunikim**

**1.** Projektimi i kulturës dhe trashëgimisë në turizëm; Krijimi i guidave informuese dhe hartave turistike në bashkëpunim me grupe të interesit, me qëllim promovimin e individualitetit të trashëgimisë kulturore.

**Objektivat:**

- a. Ndikimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin e turizmit. Analiza e ndikimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore të turizmit në komunitetet lokale. Përfitimet dhe sfidat.
- b. Motivimi dhe sjelljet e turistëve që vizitojnë vendet e trashëgimisë kulturore. Identifikimi i identitetit kulturor, nostalgjisë dhe të mësuarit nga përvoja.
- c. Vlerësimi i strategjive të ruajtjes: Shqyrtimi i strategjive efektive për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, duke vlerësuar se si turizmi mund t'i mbështesë ose pengojë këto përpjekje.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- d. Analiza e perspektivave të aktorëve të ndryshëm (p.sh., komunitetet lokale, qeveria, turistët) mbi menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit të trashëgimisë kulturore.
- e. Zhvillimi i modeleve të turizmit të qëndrueshëm: Propozimi i modeleve të turizmit të qëndrueshëm që balancojnë angazhimin e vizitorëve me ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke siguruar përfitime afatgjata si për komunitetet ashtu edhe për turistët.
- f. Projekt - Krijimi i paketave turistike lokale në bashkëpunim me grupe të interesit me qëllim krijimin e guidave informuese që promovojnë individualitetin e trashëgimisë kulturore tek turistët.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Komunikimit dhe Studimeve Kulturore

**2.** Zhvillimi dhe vlerësimi i projekt udhëzuesve për përmirësimin e aftësive të komunikimit verbal dhe joverbal si ‘soft skills’ midis grupeve specifike.

**Objektivat:**

- a) Hulumtim i modeleve teorike të komunikimit verbal dhe kodeve joverbale (p.sh., gjuha e trupit, shprehjet e fytyrës, gjestet). Analizë e përdorimit të tyre në kontekste të ndryshme.
- b) Evidentimi i ndikimeve kulturore. Formësimi i stileve dhe praktikave të komunikimit verbal dhe joverbal nën ndikimin e prejardhjes kulturore, me theks mbi implikimet e ndërveprimit ndërkulturor.
- c) Vlerësimi i efektivitetit të komunikimit verbal dhe joverbal në mjedise specifike, si institucionet, organizatat, institucionet arsimore dhe identifikimi i faktorëve që rrisin ose pengojnë qartësinë dhe mirëkuptimin.
- d) Shqyrtimi i rolit të teknologjisë (p.sh. mediat sociale, videokonferencat) në transformimin e modeleve të komunikimit dhe efektet e saj në marrëdhëniet ndërpersonale.
- e) Propozimi, zhvillimi dhe vlerësimi i projekt udhëzuesve që synojnë përmirësimin e aftësive të komunikimit verbal dhe joverbal si ‘soft skills’ midis grupeve specifike, si profesionistët, studentët, etj.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Komunikimit dhe Studimeve Kulturore

**3.** Zhvillimi i strategjive të komunikimit ndërkulturor; Propozimi i programeve të trajnimit për përmirësimin e aftësive të komunikimit midis popullatave specifike.

**Objektivat:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- a) Shqyrtimi i kornizave kulturore: Analizë e teorive dhe kornizave kryesore të komunikimit ndërkulturor, duke vlerësuar rëndësinë dhe zbatueshmërinë e tyre gjatë ndërveprimeve ndërkulturore.
- b) Identifikimi dhe eksplorimi i pengesave në procesin e komunikimit ndërkulturor, duke përfshirë dallimet gjuhësore, paragjykimet kulturore dhe keqkuptimet joverbale.
- c) Studimi i faktorëve kontekstualë (p.sh. social, politik dhe historik) dhe ndikimi i tyre në praktikën dhe perceptimet e komunikimit ndërkulturor midis grupeve të ndryshme.
- d) Vlerësimi i ndikimit të globalizimit: Si globalizimi dhe përparimet teknologjike ndikojnë në komunikimin ndërkulturor, duke u fokusuar në sfidat dhe mundësitë për të komunikuar.
- e) Zhvillimi i strategjive për ndërveprim efektiv. Propozimi i strategjive ose programeve të trajnimit që synojnë përmirësimin e aftësive të komunikimit ndërkulturor.
- f) Hartimi i një udhëzuesi informativ mbi stilet kryesore të komunikimit, normave, dhe vlerave të kulturave të ndryshme.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Komunikimit dhe Studimeve Kulturore

**4. Roli dhe ndikimi i teknologjisë në praktikën e të folurit publik.** Zhvillimi i projekteve, programeve dhe seminareve që synojnë përmirësimin e aftësive të të folurit publik.

**Objektivat:**

- a) Analiza e teknikave dhe strategjive kryesore të përdorura nga folësit e suksesshëm publikë për të angazhuar audiencën dhe për të përmirësuar transmetimin e mesazheve.
- b) Hulumtimi i perceptimit të audiencës: Si ndikon demografia e ndryshme e audiencës (p.sh., mosha, kultura, profesioni) në efektivitetin e stileve të të folurit në publik dhe metodave të mbajtjes së një fjalimi?
- c) Vlerësimi i metodave dhe praktikave që ndihmojnë folësit të menaxhojnë ankthin dhe të krijojnë besim në situatat e të folurit publik, duke përfshirë teknikat psikologjike dhe fizike.
- d) Studimi i rolit dhe ndikimit të teknologjisë (p.sh. prezantime në Power Point, mediat sociale) në praktikën e të folurit publik dhe angazhimit të audiencës në mjediset bashkëkohore.
- e) Zhvillimi i programeve, seminareve dhe projekteve që synojnë përmirësimin e aftësive të të folurit në publik midis grupeve specifike, si studentët, profesionistët ose drejtuesit e komunitetit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Komunikimit dhe Studimeve Kulturore

**5. Zhvillimi i kornizave për edukimin mediatik, vlerësimi i kornizave aktuale dhe propozimi i programeve të reja me synim rritjen e edukimit mediatik në popullata të ndryshme.**

**Objektivat:**

- a) Evidentimi i tendencave aktuale në konsumin e mediave, duke u fokusuar në mënyrën se si teknologjia ndikon në zakonet dhe preferencat e ndjekjes.
- b) Eksplorimi i efekteve të platformave të mediave sociale në diskursin publik, formimin e identitetit dhe ndërtimin e komunitetit, duke vlerësuar implikimet pozitive dhe negative.
- c) Vlerësimi i ndikimit të teknologjive në zhvillim (p.sh. AI, realiteti virtual) në prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e medias, duke përfshirë ndryshimet në angazhimin e audiencës.
- d) Analiza e çështjeve etike në media dhe teknologji, të tilla si shkeljet e privatësisë, mosinformimi, keqinformimi dhe roli i kompanive mediatike në formësimin e perceptimit publik.
- e) Zhvillimi i kornizave për edukimin mediatik. Vlerësimi i kornizave aktuale dhe propozimi i kornizave të reja ose programeve në kontekste arsimore që synojnë rritjen e edukimit mediatik midis popullatave të ndryshme, duke theksuar mendimin kritik dhe informimin e vazhduar.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Komunikimit dhe Studimeve Kulturore

**6. Zhvillimi i projekteve për përmirësimin e aftësive të komunikimit në grup për mësimdhënësit dhe studentët, nëpërmjet platformave dhe paneleve interaktive.**

**Objektivat:**

- a) Analiza e dinamikës së komunikimit brenda grupeve në kontekste arsimore, duke u fokusuar në mënyrën se si ndërveprimet në grup ndikojnë në bashkëpunimin, angazhimin dhe rezultatet e të nxënit.
- b) Shqyrtim i roleve dhe përgjegjësi brenda grupit: Evidentimi i roleve që luajnë individët në mjediset e grupit dhe se si këto role ndikojnë në efektivitetin e komunikimit në grup dhe performancën e përgjithshme të grupit në kontekstet arsimore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- c) Vlerësimi i ndikimit dhe efekteve të mjeteve të komunikimit të ndërmjetësuar nga teknologjia (p.sh., forume diskutimi, video-konferenca) në ndërveprimet në grup dhe proceset e të mësuarit si në arsimin tradicional ashtu edhe në atë online.
- d) Analiza e strategjive për menaxhimin dhe zgjidhjen e konfliktit në mjediset e grupit, duke vlerësuar efektivitetin e tyre në promovimin e dialogut konstruktiv dhe rritjen e kohezionit në grup.
- e) Zhvillimi i projekteve që synojnë përmirësimin e aftësive të komunikimit në grup për mësimdhënësit dhe studentët, duke u fokusuar në nxitjen e bashkëpunimit efektiv dhe rritjen e përvojave të të mësuarit.

**Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Komunikimit dhe Studimeve Kulturore

➤ **Departamenti i gjuhës Frënge ka këto projekte kërkimore:**

1. Strategji të komunikimit në gjuhë të huaj për promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.

**Objektivat:**

- a. Zhvillimin e një pune kërkimore mbi studimet gjuhësore në komunikimin turistik, në shkallë evropiane, me fokus në trashëgiminë kulturore, një ekzaminim të orientimeve dhe strategjive kombëtare në drejtim të promovimit të saj dhe një zbulim të studimeve më të fundit të turizmit kulturor.
- b. Analizën e një korpusi që do të krijohet nga dokumente autentike turistike për Shqipërinë në gjuhë të huaj: guida turistike, libra prezantues të trashëgimisë kulturore, afishe, broshura turistike, botime në shtypin e përgjithshëm dhe të specializuar, faqet e agjencive turistike, hotelet dhe restorantet, portalet zyrtare, faqet dhe blogjet e turizmit, spotet reklamuese. Ky korpus do të jetë objekt i analizave diskursive e komunikative, leksikore e terminologjike, stilistike, përkthyes dhe ndërkulturore. Parametrat dhe specifikat e identifikuara (zhanret e shkruara dhe gojore, situatat dhe pjesëmarrësit monologjike, dialogue, komunikuese (statusi, roli, karakteristikat fizike, socio-profesionale), hapësirë-koha, objektivat e shfaqura dhe të fshehura), veçoritë morfologjike, sintaksore, leksikore, terminologjike, çështje që lidhen me përkthimin e teksteve turistike, dimensionin ndërkulturor që përmban (imazhi i vendit, i banorëve dhe i identitetit kombëtar të ndërtuar, vetë-dhe heterostereotipat, klishe të kulturore dhe historike, realiteti, termat) do të përbëjnë çështje të kërkimit. Do të



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

përcaktohet ndikimi i secilit prej këtyre komponentëve të komunikimit në efektet e tij të mundshme pragmatike të marrësit, vizitorët potencialë të trashëgimisë kulturore të paraqitur.

- c. Ndërtimi i një modeli të komunikimit turistik për përmirësimin e promovimit të trashëgimisë kulturore. Do të bëhet një krahasim i rezultateve, praktikave dhe modeleve të vëzhguara me vendet e huaja. Do të zhvillohen reflektime/sugjerime si edhe do të jepen modele të komunikimit të sukseshëm të strategjive të komunikimit në gjuhë të huaj.

➤ **Departamenti i gjuhës Spanjolle ka këto projekte kërkimore:**

1. Shqipëria bektashiane, një itinerar i ri në zemër të Ballkanit.

**Objektivat:**

- a. Të përpiqemi të ndërtojmë një narrativë në të cilën pikat e forta dhe të dobëta të vendit tonë të dalin në pah kundrejt turistëve potencialë spanjollë, ndoshta duke u bazuar në pikat tradicionalisht të forta si të çdo vendi tjetër, të tilla si: Historia/ Arkeologjia/ folklori; riviera/ malet; kulinaria; multikulturalizmi: mitet dhe heronjtë lokalë; Por gjithashtu ku të ndërtohet një narrativë edhe mbi ato pika që kemi të përbashkëta apo që na dallojnë nga spanjishtfolësit e tjerë, të tilla si: bashkëjetesa fetare; dallimet që rrjedhin nga kalimi nëpër sisteme diktatoriale, apo në tranzicione (paralelizmi me Spanjën); identiteti ballkanik mesdhetar etj..
2. Kujtesa historike dhe identiteti kulturor në ligjërimet letrare, dëshmuere dhe dokumentare: një qasje ndërkulturore

**Objektivat:**

- a. Të analizohet roli i ligjërimeve letrare, dëshmuere, historike dhe dokumentare në komunikimin ndërkulturor, duke shqyrtuar mënyrën se si ato përfaqësojnë ngjarjet historike, ndërtojnë kujtesën kulturore dhe historike, si dhe formësojnë identitetin kulturor në kontekste të ndryshme evropiane.
- b. Të studiohet marrëdhënia ndërmjet letërsisë, dëshmisë, dokumentit, historisë dhe kujtesës.
- c. Të analizohet mënyra se si zhanre të ndryshme tekstuale përfaqësojnë ngjarje historike nga perspektiva të ndryshme kulturore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- d. Të shqyrtohet funksioni i ligjërimeve letrare, dëshmuere dhe dokumentare si mjete të komunikimit dhe ndërmjetësimit ndërkulturor.
- e. Të vlerësohet roli i kujtesës individuale dhe kolektive në ndërtimin e identitetit kulturor.
- f. Të krahasohen tekste dhe dokumente nga vende të ndryshme, si Spanja, Shqipëria, Italia, Franca apo kontekste të tjera evropiane.
- g. Të identifikohen ngjashmëritë dhe dallimet në mënyrën se si kultura të ndryshme rrëfejnë, interpretojnë dhe transmetojnë të kaluarën historike.

**Grupi mësimor – kërkimor:** Letërsi- Komunikim i Gjuhës Spanjolle

3. Turizmi dhe komunikimi ndërkulturor

**Objektivat:**

- a. Të harmonizohet bashkëpunimi ndërdisiplinor midis komunikimit turistik dhe përkthimit terminologjik, duke përdorur kryesisht burime të dorës së parë (materiale muzeale, guida turistike, panele interpretimi, broshura, etj.formate) por edhe vepra letrare, historike etj.
- b. Të aftësohen studiuesit dhe doktorantët në komunikimin ndërkulturor, me fokus të veçantë në komunikimin ndërkulturor dhe në terminologjinë e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, si dhe në përshtatjen e saj për receptorin e ri.
- c. Të zhvillohen modele komunikimi turistik që integrojnë dimensionin kulturor, gjuhësor dhe interpretativ.
- d. Të kontribuohet në standardizimin dhe pasurimin e terminologjisë dygjuhëshe (shqip–spanjisht) në fushën e trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

**Grupi mësimor – kërkimor:** Letërsi- Komunikim i Gjuhës Spanjolle

➤ **Departamenti i gjuhës Sllave dhe Ballkanike ka këto projekte kërkimore:**

- 1. Çështje të komunikimit ndërkulturor gjuhësor ndërmjet gjuhëve.

**Objektivat:**

- a. Të njohë dhe të studiojë mjetet e komunikimit, teknikat dhe strategjitë e duhura.
- b. Të njohë dhe të studiojë elementë të komunikimit joverbal.
- c. Të studiojë teori të ndryshme të komunikimit.
- d. Të studiojë procesin e komunikimit, mesazhin, qëllimin e mesazhit si dhe rëndësinë e komunikimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- e. Të studiojë dhe të kuptojë diversitetin kulturor.
- f. Të dallojë çështje të komunikimit dhe të moskomunikimit, të statusit të ri për tjetrin, të bashkëjetesës mes njerëzve dhe nevojës për komunikim.

➤ **Departamenti i gjuhës Gjermane ka këto projekte kërkimore:**

- 1. Komunikimi verbal dhe joverbal, masmedia

**Objektivat:**

- a. Thellimi hulumtues në njohjen shkencore të komunikimit verbal dhe joverbal, kulturave, rriteve, zakoneve dhe mediave, si realitet reflektues e përqasës.
  - b. Aftësia për të kapërcyer barrierat gjatë shkëmbimeve verbale dhe joverbale si paragjykimet, identiteti (i lidhur me ndjenjën e përkatësisë në grupe të caktuara), stereotipet, etnocentrizmi dhe relativizmi kulturor etj.
  - c. Ndërgjegjësimi për variantet dhe mundësitë e ndryshme gjuhësore dhe kulturore të përcjelljes së përmbytjes për një zgjedhje më të mirë të formës së komunikimit me qëllimin e një komunikimi efektiv, të saktë, të qëllimshëm dhe të respektueshëm për njerëzit të kulturave të tjera.
- 2. Komunikimi ndërkulturor në kontekstin bilingual shqip-gjermanisht dhe roli i tij në proceset e komunikimit, edukimit dhe ndërveprimit social

**Objektivat:**

- a. Analiza e ngjashmërive dhe dallimeve ndërkulturore midis kulturës shqiptare dhe asaj gjermane në situata të ndryshme komunikimi.
- b. Studimi i modeleve të komunikimit verbal dhe joverbal, si dhe ndikimi i tyre në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor.
- c. Evidentimi i stereotipeve, paragjykimeve dhe barrierave kulturore që ndikojnë në komunikimin ndërkulturor dhe zhvillimi i strategjive për tejkalimin e tyre.
- d. Trajtimi i komunikimit ndërkulturor në kontekstin e arsimit, me fokus të veçantë në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj në kontekstin shqiptar dhe ndërkombëtar.
- e. Hulumtimi i marrëdhënies gjuhë–kulturë–identitet dhe ndikimi i saj në proceset e ndërveprimit social dhe akademik.
- f. Studimi i kompetencës ndërkulturore dhe rolit të saj në komunikimin institucional, akademik, profesional dhe digjital.
- g. Analiza e ndikimit të globalizimit, migrimit dhe mediave digjitale në zhvillimin e komunikimit ndërkulturor dhe identiteteve kulturore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

h. Hulumtimi i situatave kritike (“critical incidents”) dhe keqkuptimeve ndërkulturore në komunikimin shqip-gjerman, si dhe identifikimi i strategjive efektive të ndërmjetësimit kulturor.

**Grupi mësimor-kërkimor:** Gjuhësi dhe Komunikim; Gjuhësi-Didaktikë

3. Qasje didaktike dhe metodike në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj në kontekstin ndërkulturor

**Objektivat:**

- a. Studimi i metodave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj në kontekstin shqiptar.
- b. Analiza e rolit të kompetencës ndërkulturore në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhëve të huaja.
- c. Hulumtimi i qasjeve didaktike që nxisin komunikimin autentik, mendimin kritik dhe ndërveprimin kulturor në klasë.
- d. Trajtimi i përdorimit të mediave digjitale, inteligjencës artificiale dhe platformave online në mësimdhënien e gjermanishtes.
- e. Analiza e materialeve mësimore dhe teksteve didaktike nga perspektiva gjuhësore, kulturore dhe metodike.
- f. Studimi i rolit të mësuesit si ndërmjetës kulturor dhe i ndikimit të dinamikës së grupit në motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- g. Hulumtimi i formave inovative të vlerësimit dhe zhvillimit të kompetencave gjuhësore, komunikative dhe ndërkulturore.
- h. Evidentimi i sfidave të mësimdhënies së gjermanishtes në mjedise shumëgjuhëshe dhe shumëkulturore.
- i) Lidhja e teorive bashkëkohore të didaktikës dhe metodikës me praktikën e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj.

**Grupi mësimor-kërkimor:** Gjuhësi dhe Komunikim; Gjuhësi-Didaktikë

4. Digjitalizimi dhe komunikimi ndërkulturor në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj

**Objektivat:**

- a. Studimi i ndikimit të digjitalizimit në proceset e komunikimit, ndërveprimit dhe mësimnxënies në kontekstin ndërkulturor.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- b. Analiza e përdorimit të platformave digjitale, mediave sociale dhe aplikacioneve edukative në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj.
- c. Hulumtimi i rolit të inteligjencës artificiale dhe teknologjive të reja në zhvillimin e kompetencave gjuhësore, komunikative dhe ndërkulturore.
- d. Evidentimi i avantazheve dhe sfidave të mësimdhënies online dhe hibride në kontekstin shqiptar dhe ndërkombëtar.
- e. Studimi i komunikimit virtual dhe i formave të reja të ndërveprimit kulturor në mjediset digjitale.
- f. Analiza e materialeve dhe burimeve digjitale nga perspektiva didaktike, metodike dhe ndërkulturore.
- g. Hulumtimi i rolit të mediave digjitale në motivimin, autonominë dhe bashkëpunimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënës.
- h) Trajtimi i etikës digjitale, identitetit virtual dhe kompetencës mediatike në komunikimin ndërkulturor.
- i) Zhvillimi i qasjeve inovative kërkimore dhe pedagogjike që ndërthurin komunikimin ndërkulturor, didaktikën dhe teknologjinë.

**✓ DREJTIMI KRYESOR “STUDIME PËRKTHIMORE DHE TË INTERPRETIMIT”**

➤ **Projektet kërkimore për Departamentin e Gjuhës Angleze:**

1. Vlerësimit i cilësisë së përkthimeve të romaneve, apo tregimeve të shkruar në gjuhën angleze nga autorë të ndryshëm dhe mënyra se si janë përcjellë në gjuhën shqipe nga dy ose më shumë përkthyes

**Objektivat:**

- a) Analiza e procesit të perkthimit dhe vlerësimit të përkthimeve të realizuara përpara viteve '90 dhe pas viteve '90, në zhanrin e prozës letrare, duke u përqendruar në shembuj tipikë të përcjelljes së tipareve të gjuhës dhe stilit të veçantë të autorit/autorëve në gjuhën e përkthimit.
- b) Analizë e thelluar dhe gjithëpërfshirëse e aspekteve morfologjike, sintaksore, leksikore, stilistike e tekstit letrar dhe ndërgjegjësimi në lidhje me tiparet e veçanta tekstore.
- c) Realizimi i analizës së detajuar e gjithëpërfshirëse të veprave letrare në zhanrin e prozës letrare, bazuar në dy ose më shumë versione të veprave perkthyer ne gjuhën shqipe, në mënyrë që të vihen në dukje e të theksohen tiparet specifike te gjuhës dhe stilit të përdorur prej shkrimtarit/ëve.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- d) Hedhja dritë dhe sigurimi i informacionit sa më të bollshëm e pothuaj shterues në lidhje me përkthimet në gjuhën angleze të një, ose më shumë prej veprave të shkruara në gjuhën angleze nga autorë të ndryshëm, në dy këndvështrime e plane, përkatësisht planin teorik dhe planin praktik.
- e) Shfrytëzimi i metodave të ndryshme të kërkimit shkencor në fushën e Studimeve Përkthimore, përkatësisht, metoda sasiore, metoda cilësore dhe e ndërthurur.
- f) Shfrytëzimi i instrumenteve sasiore të kërkimit shkencor në fushën e Studimeve Përkthimore, kryesisht nëpërmjet analizës së korpusëve gjuhësore e kulturore shumëgjuhëshe, paralele dhe të krahasueshme, nëpërmjet zbatimit të inteligjencës artificiale dhe aplikacioneve të ndryshme kompjuterike.
- g) Identifikimi dhe thellimi i mëtejshëm në metodologjitë e shfrytëzuara në këtë fushë specifike të kërkimit shkencor të Studimeve Përkthimore. në lidhje me problematikat përkthimore të tekstit letrar.
- h) Analiza e tipareve dhe veçorive të aspekteve të vecantë tek dy, ose më shumë versione të përkthyerave të veprave origjinale, duke theksuar ngjashmeritë, si edhe ndryshimet që kanë pësuar metodat dhe qasjet përkthimore në rrjedhën e viteve.
- i) Të përshkruhen dhe analizohen teorikisht, si edhe praktikisht dy ndërprirjet kryesore të vërejtura në analizën e përkthimeve në ditët e sotme, përkatësisht huajtëzimi dhe amëtarizimi, nëpërmjet shembujve konkretë të përfshira në korpuset gjuhësore e kulturore, me synimin që të analizohen këto aspekte të përkthimit nga gjuha angleze drejt gjuhës shqipe.
- j) Të hidhet dritë mbi transformimet e mundshme të procesit të përkthimit, profesionit të përkthyesit letrar, si edhe ecurinë e përkthimit gjatë viteve.
- k) Identifikimi dhe vlerësimi i standardeve në përkthimin e letërsisë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, duke u përqëndruar kryesisht në përshtatjet dhe përcjelljen e barasvlerësve në nivele të ndryshme tekstore, kuptimësore, gramatikore, leksikore, stilistikore e kulturore.
- l) Të kontribuojë për Studimet Përkthimore në Shqipëri duke hulumtuar punën e përkthyesve më të mirë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
- m) Të hidhet dritë në ato aspekte të shumëllojshme të përkthimit të krahasuar dhe vlerësimit të përkthimeve, bazuar në 12 drejtimet e kërkimit shkencor në Studimet Përkthimore, të identifikuara nga Williams, Jenny & Andrew Chesterman. (2002, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në studimin e një veprave letrare të përkthyer, duke u përqëndruar në *aspektet kulturore, gjuhësore dhe metagjuhësore* të veprave dhe në përcjelljen e këtyre aspekteve në kontekstin e problematikës përkatëse.
- n) Të analizohen në mënyrë pothuajse shteruese strategjitë, përftesat dhe zgjidhjet përkthimore në këndvështrimin e stilistikës gjuhësore dhe pragmatikës.
- o) Studimi i rolit të kulturës në përkthim si një nga sfidat më të vështira për përkthyesin dhe përkthimin në përgjithësi;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- p) Të evidentojë e nxjerrë në pah kontributin e gjuhëtarëve, përkthyesve dhe studiuesve shqiptarë në studimet mbi përkthimin në shekullin e 20-të dhe 21;
- q) Njohja e vështirësive e sfidave me të cilat janë ndeshur dhe vazhdojnë të ndeshen studiuesit shqiptarë të Studimeve Përkthimore;

**Grupi mësimor- kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Studimeve Përkthimore dhe të Interpretimit

**2. Vlerësimi i cilësisë së përkthimeve të vëllimeve poetike të shkruara në gjuhën angleze nga poetë të ndryshëm dhe mënyra se si janë përcjellë në gjuhën shqipe nga dy ose më shumë përkthyes**

**Objektivat:**

- a) Analiza e procesit të përkthimit dhe vlerësimi të përkthimeve të realizuara përpara viteve '90 dhe pas viteve '90, në zhanrin e poezisë, duke u përqendruar në shembuj tipikë të përcjelljes së tipareve të gjuhës dhe stilit të veçantë të autorit/autorëve në gjuhën e përkthimit.
- b) Analizë e thelluar dhe gjithëpërfshirëse e aspekteve morfologjike, sintaksore, leksikore, stilistike e tekstit letrar dhe ndërgjegjësimi në lidhje me tiparet e veçanta tekstore.
- c) Realizimi i analizës së detajuar e gjithëpërfshirëse të veprave letrare në zhanrin e poezisë, bazuar në dy ose më shumë versione të veprave përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të vihen në dukje e të theksohen tiparet specifike të gjuhës dhe stilit të përdorur prej poetit/ëve.
- d) Hedhja dritë dhe siguri i informacionit sa më të bollshëm e pothuaj shterues në lidhje me përkthimet në gjuhën angleze të një, ose më shumë prej veprave të shkruara në gjuhën angleze nga autorë të ndryshëm, në dy këndvështrime të plane, përkatësisht planin teorik dhe planin praktik.
- e) Sfidat e përkthimit të poezisë. Hedhje drite në lidhje me profilin e përkthyesit, nëse duhet të jetë vetëm përkthyes, apo poezinë mund ta përkthejnë edhe poetët.
- f) Shfrytëzimi i metodave të ndryshme të kërkimit shkencor në fushën e Studimeve Përkthimore, përkatësisht, metoda sasiore, metoda cilësore dhe e ndërthurur.
- g) Shfrytëzimi i instrumenteve sasiore të kërkimit shkencor në fushën e Studimeve Përkthimore, kryesisht nëpërmjet analizës së korpuseve gjuhësore e kulturore shumëgjuhëshe, paralele dhe të krahasueshme, nëpërmjet zbatimit të inteligjencës artificiale dhe aplikacioneve të ndryshme kompjuterike.
- h) Identifikimi dhe thellimi i mëtejshëm në metodologjitë e shfrytëzuara në këtë fushë specifike të kërkimit shkencor të Studimeve Përkthimore. në lidhje me problematikat përkthimore të tekstit letrar.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- i) Analiza e tipareve dhe veçorive të aspekteve të vecantë tek dy, ose më shumë versione të perkthyer të vepres/ave origjinale, duke theksuar ngjashmerite, si edhe ndryshimet që kanë pësuar metodat dhe qasjet perkthimore në rrjedhën e viteve.
- j) Të përshkruhen dhe analizohen teorikisht, si edhe praktikisht dy ndërprerjet kryesore të vërejtura në analizën e perkthimeve në ditët e sotme, perkatesisht huajtëzimi dhe amëtarizimi, nëpërmjet shembujve konkretë të përfshira në korpuset gjuhësore e kulturore, me synimin që të analizohen këto aspekte të perkthimit nga gjuha angleze drejt gjuhës shqipe.
- k) Të hidhet dritë mbi transformimet e mundshme të procesit të perkthimit, profesionit të perkthyesit letrar, si edhe ecurinë e perkthimit gjatë këtyre viteve.
- l) Identifikimi dhe vlerësimi i standardeve në perkthimin e letërsisë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, duke u përqëndruar kryesisht në përshtatjet dhe përcjelljen e barasvlerësve në nivele të ndryshme tekstore, kuptimësore, gramatikore, leksikore, stilistikore e kulturore.
- m) Të kontribuojë për Studimet Perkthimore në Shqipëri duke hulumtuar punën e perkthyesve më të mirë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
- n) Të hidhet dritë në ato aspekte të shumëllojshme të perkthimit të krahasuar dhe vlerësimit të perkthimeve, bazuar në 12 drejtimit e kërkimit shkencor në Studimet Perkthimore, të identifikuara nga Williams, Jenny & Andrew Chesterman. (2002, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në studimin e një vepre letrare të perkthyer, duke u përqëndruar në *aspektet kulturore, gjuhësore dhe metagjuhësore* të veprave dhe në përcjelljen e këtyre aspekteve në kontekstin e problematikës perkatesë.
- o) Të analizohen në mënyrë pothuajse shteruese strategjitë, përftesat dhe zgjidhjet perkthimore në këndvështrimin e stilistikës gjuhësore dhe pragmatikës, veçanërisht në lidhje me specifikat e perkthimit të poezisë.
- p) Studimi i rolit të kulturës në perkthim si një nga sfidat më të vështira për perkthyesin dhe perkthimin në përgjithësi;
- q) Të evidentojë e nxjerrë në pah kontributin e gjuhëtarëve, perkthyesve dhe studiuesve shqiptarë në studimet mbi perkthimin në shekullin e 20-të dhe 21;
- r) Njohja e vështirësive e sfidave me të cilat janë ndeshur dhe vazhdojnë të ndeshen studiuesit shqiptarë të Studimeve Perkthimore;

**Grupi mësimor- kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Studimeve Perkthimore dhe të Interpretimit

**3. Vlerësimit i cilësisë së perkthimeve të dramave të shkruara në gjuhën angleze nga dramaturgë të ndryshëm dhe mënyra se si janë përcjellë në gjuhën shqipe nga dy ose më shumë perkthyes**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**Objektivat:**

- a) Analiza e procesit të përkthimit dhe vlerësimit të përkthimeve të realizuara përpara viteve '90 dhe pas viteve '90, në zhanrin e dramës, duke u përqendruar në shembuj tipikë të përcjelljes së tipareve të gjuhës dhe stilit të veçantë të autorit/autorëve në gjuhën e përkthimit.
- b) Analizë e thelluar dhe gjithëpërfshirëse e aspekteve morfologjike, sintaksore, leksikore, stilistike e tekstit letrar dhe ndërgjegjësimi në lidhje me tiparet e veçanta tekstore.
- c) Realizimit i analizës së detajuar e gjithëpërfshirëse të veprave letrare në zhanrin e dramës, bazuar në dy ose më shumë versione të veprave përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të vihen në dukje e të theksohen tiparet specifike të gjuhës dhe stilit të përdorur prej dramaturgut/ëve.
- d) Hedhja dritë dhe sigurimi i informacionit sa më të bollshëm e pothuaj shterues në lidhje me përkthimet në gjuhën angleze të një, ose më shumë prej veprave të shkruara në gjuhën angleze nga autorë të ndryshëm, në dy këndvështrime të plane, përkatësisht planin teorik dhe planin praktik.
- e) Shfrytëzimi i metodave të ndryshme të kërkimit shkencor në fushën e Studimeve Përkthimore, përkatësisht, metoda sasiore, metoda cilësore dhe e ndërthurur.
- f) Shfrytëzimi i instrumenteve sasiore të kërkimit shkencor në fushën e Studimeve Përkthimore, kryesisht nëpërmjet analizës së korpuseve gjuhësore e kulturore shumëgjuhëshe, paralele dhe të krahasueshme, nëpërmjet zbatimit të inteligjencës artificiale dhe aplikacioneve të ndryshme kompjuterike.
- g) Identifikimi dhe thellimi i mëtejshëm në metodologjitë e shfrytëzuara në këtë fushë specifike të kërkimit shkencor të Studimeve Përkthimore. në lidhje me problematikat përkthimore të tekstit letrar.
- h) Analiza e tipareve dhe veçorive të aspekteve të veçantë të dy, ose më shumë versione të përkthyer të veprave origjinale, duke theksuar ngjashmeritë, si edhe ndryshimet që kanë pesuar metodat dhe qasjet përkthimore në rrjedhën e viteve.
- i) Të përshkruhen dhe analizohen teorikisht, si edhe praktikisht dy ndërprirjet kryesore të vërejtura në analizën e përkthimeve në ditët e sotme, përkatësisht huajtëzimi dhe amëtarizimi, nëpërmjet shembujve konkretë të përfshira në korpuset gjuhësore e kulturore, me synimin që të analizohen këto aspekte të përkthimit nga gjuha angleze drejt gjuhës shqipe.
- j) Të hidhet dritë mbi transformimet e mundshme të procesit të përkthimit, profesionit të përkthyesit letrar, si edhe ecurinë e përkthimit gjatë ketyre viteve.
- k) Identifikimi dhe vlerësimi i standardeve në përkthimin e letërsisë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, duke u përqendruar kryesisht në përshtatjet dhe përcjelljen e barasvlerësve në nivele të ndryshme tekstore, kuptimësore, gramatikore, leksikore, stilistikore e kulturore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- l) Të kontribuojë për Studimet Përkthimore në Shqipëri duke hulumtuar punën e përkthyesve më të mirë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
- m) Të hidhet dritë në ato aspekte të shumëllojshme të përkthimit të krahasuar dhe vlerësimit të përkthimeve, bazuar në 12 drejtimet e kërkimit shkencor në Studimet Përkthimore, të identifikuara nga Williams, Jenny & Andrew Chesterman. (2002, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në studimin e një veprë letrare të përkthyer, duke u përqëndruar në *aspektet kulturore, gjuhësore dhe metagjuhësore* të veprave dhe në përcjelljen e këtyre aspekteve në kontekstin e problematikës përkatëse.
- n) Të analizohen në mënyrë pothuajse shteruese strategjitë, përftesat dhe zgjidhjet përkthimore në këndvështrimin e stilistikës gjuhësore dhe pragmatikës, veçanërisht në lidhje me specifikat e përkthimit të dramave.
- o) Të analizohen marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet dramaturgut (nëse është gjallë)-përkthyesit dhe regjisorit gjatë vënies në skenë të veprës përkatëse.
- p) Studimi i rolit të kulturës në përkthim si një nga sfidat më të vështira për përkthyesin dhe përkthimin në përgjithësi;
- q) Të evidentojë e nxjerrë në pah kontributin e gjuhëtarëve, përkthyesve dhe studiuesve shqiptarë në studimet mbi përkthimin në shekullin e 20-të dhe 21.
- r) Njohja e vështirësive e sfidave me të cilat janë ndeshur dhe vazhdojnë të ndeshen studiuesit shqiptarë të Studimeve Përkthimore.

**Grupi mësimor- kërkimor i angazhuar:** Grupi kërkimor - mësimor i Studimeve Përkthimore dhe të Interpretimit

➤ **Projektet kërkimore për Departamentin e gjuhës Spanjolle**

- 1. Përkthimet letrare të letërsisë spanjolle në gjuhën shqipe

**Objektivat:**

- a) Të studiohet historia e përkthimit të letërsisë hispanike në gjuhën shqipe.
- b) Të analizohen strategjitë përkthimore të përdorura në përkthimin e veprave letrare.
- c) Të analizohen dhe të komentohen nga pikëpamja përkthimore (jo thjesht gjuhësore) tekstet e përkthyer sipas qasjeve bashkëkohore të studimeve përkthimore, mundësisht sipas shkollës së konjitivizmit dhe funksionalizmit në përkthim.
- d) Të vlerësohet roli i përkthimit letrar si urë komunikimi ndërkulturor.
- e) Të evidentohen sfidat në përkthimin e elementeve kulturore.
- f) Të edukohet brezi i ri me një qasje kritike në përkthimin letrar.

➤ **Projektet kërkimore për Departamentin e gjuhës Gjermane**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**1. Përkthimi si ndërmjetësim gjuhësor, kulturor dhe komunikativ në kontekstin shqip-gjermanisht**

**Objektivat:**

- a) Analiza e përkthimit si proces ndërmjetësimi midis gjuhës, kulturës dhe kontekstit social në marrëdhënien shqip-gjermanisht.
- b) Studimi i rolit të përkthyesit si ndërmjetës kulturor dhe komunikativ në situata të ndryshme përkthimore, si përkthimi letrar, institucional, akademik dhe profesional.
- c) Hulumtimi i sfidave që lindin gjatë përkthimit të elementeve kulturore, realieve, koncepteve shoqërore dhe referencave historike nga shqipja në gjermanisht dhe anasjelltas.
- d) Evidentimi i strategjive përkthimore që përdoren për ruajtjen, përshtatjen ose shpjegimin e elementeve kulturore në tekstin e përkthyer.
- e) Analiza e marrëdhënies midis ekuivalencës, funksionit komunikativ dhe pritshmërive të lexuesit në përkthimin ndërkulturor.
- f) Studimi i rasteve të keqkuptimeve kulturore në përkthim dhe i mënyrave për shmangien e tyre përmes ndërmjetësimit gjuhësor dhe kulturor.
- g) Hulumtimi i rolit të kompetencës ndërkulturore në formimin profesional të përkthyesve.
- h) Zhvillimi i një qasjeje kërkimore që e sheh përkthimin jo vetëm si transferim gjuhësor, por si akt interpretimi, ndërmjetësimi dhe komunikimi ndërkulturor.

**Grupi mësimor-kërkimor:** Përkthim, Gjuhësi e Aplikuar

**2. Përkthimi letrar shqip-gjermanisht dhe sfidat e transferimit të stileve, kulturës dhe identitetit tekstor**

**Objektivat:**

- a) Studimi i veçorive të përkthimit letrar nga shqipja në gjermanisht dhe nga gjermanishtja në shqip, me fokus në roman, tregim, poezi, letërsi për fëmijë dhe letërsi bashkëkohore.
- b) Analiza e strategjive për përkthimin e stilit, figuracionit, metaforave, idiomave, frazeologjizmave dhe shprehjeve kulturore në tekstin letrar.
- c) Hulumtimi i mënyrës se si ruhet ose transformohet identiteti kulturor dhe estetik i veprës origjinale gjatë procesit të përkthimit.
- d) Krahasimi i përkthimeve të ndryshme të të njëjtit tekst letrar për të evidentuar dallimet në zgjedhjet leksikore, stilistike dhe kulturore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- e) Studimi i rolit të përkthyesit në interpretimin e veprës letrare dhe në ndërtimin e marrëdhënies midis autorit, tekstit dhe lexuesit të gjuhës pritëse.
- f) Analiza e përkthimit të letërsisë shqiptare në gjuhën gjermane si formë e prezantimit të kulturës shqiptare në hapësirën gjermanofone.
- g) Hulumtimi i sfidave të përkthimit të letërsisë për fëmijë dhe të rinj, veçanërisht në rastet kur teksti përmban lojëra gjuhësore, humor, emra të përveçëm, elemente folklorike ose realie kulturore.
- h) Zhvillimi i një modeli analitik për vlerësimin e cilësisë së përkthimit letrar në çiftin gjuhësor shqip-gjermanisht.

**3. Përkthimi i teksteve juridike, administrative dhe zyrtare në kontekstin shqip-gjermanisht**

**Objektivat:**

- a) Analiza e veçorive gjuhësore, terminologjike dhe stilistike të teksteve juridike, administrative dhe zyrtare në shqip dhe gjermanisht.
- b) Studimi i sfidave që dalin gjatë përkthimit të dokumenteve zyrtare, si vendime gjyqate, akte noteriale, certifikata, kontrata, autorizime, dëshmi, programe studimi dhe dokumente institucionale.
- c) Hulumtimi i problemit të ekuivalencës juridike dhe institucionale midis sistemeve shqiptare dhe gjermane/austriake/zvicerane.
- d) Evidentimi i rasteve kur përkthimi fjalë për fjalë nuk është i mjaftueshëm për shkak të dallimeve midis sistemeve ligjore dhe administrative.
- e) Analiza e strategjive për përkthimin e termave juridikë, formulimeve standarde, titujve institucionale, vendimeve administrative dhe strukturave burokratike.
- f) Studimi i rolit të saktësisë, qartësisë, përgjegjësisë profesionale dhe etikës në përkthimin zyrtar.
- g) Hulumtimi i ndikimit të formatit, strukturës dhe paraqitjes vizuale të dokumentit në përkthimin zyrtar dhe të noterizuar.
- h) Hartimi i një modeli praktik për përkthimin e dokumenteve juridike dhe zyrtare në çiftin gjuhësor shqip-gjermanisht.

**4. Përkthimi i frazeologjizmave, idiomave dhe shprehjeve kulturore në tekstet shqip-gjermanisht**

**Objektivat:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- a) Studimi i frazeologjizmave, idiomave, proverbave dhe shprehjeve të ngulitura si një nga sfidat kryesore të përkthimit ndërgjuhësor dhe ndërkulturor.
- b) Analiza e mënyrës se si përkthehen njësitë frazeologjike nga gjermanishtja në shqip dhe nga shqipja në gjermanisht në tekste letrare, publicistike, mediatike dhe didaktike.
- c) Evidentimi i rasteve të ekuivalencës së plotë, ekuivalencës së pjesshme, përshtatjes kulturore, parafrazimit dhe humbjes semantike gjatë përkthimit.
- d) Hulumtimi i lidhjes midis kuptimit idiomatik, ngarkesës kulturore dhe funksionit stilistik të shprehjeve frazeologjike.
- e) Analiza e problemeve që lidhen me përkthimin e metaforave kulturore, shprehjeve popullore, formulimeve humoristike dhe ndërtimeve idiomatike.
- f) Studimi i rolit të kontekstit në interpretimin dhe përkthimin e njësive frazeologjike.
- g) Krahasimi i strategjive përkthimore të përdorura nga përkthyes të ndryshëm në trajtimin e të njëjtave njësi frazeologjike.
- h) Zhvillimi i një kuadri metodologjik për analizën kontrastive të frazeologjizmave në përkthim.

## **5. Teknologjia, inteligjenca artificiale dhe përkthimi në epokën digjitale**

### **Objektivat:**

- a) Studimi i ndikimit të teknologjisë digjitale dhe inteligjencës artificiale në procesin e përkthimit profesional dhe akademik.
- b) Analiza e përdorimit të mjeteve të përkthimit automatik, programeve CAT, korpuseve digjitale dhe platformave terminologjike në përkthimin shqip-gjermanisht.
- c) Hulumtimi i avantazheve dhe kufizimeve të përkthimit automatik në krahasim me përkthimin njerëzor.
- d) Studimi i rolit të post-editimit në përmirësimin e teksteve të përkthyer automatikisht.
- e) Analiza e gabimeve tipike të përkthimit automatik në tekstet juridike, letrare, akademike dhe të specializuara.
- f) Evidentimi i ndikimit të teknologjisë në formimin e kompetencës përkthimore të studentëve dhe përkthyesve të rinj.
- g) Hulumtimi i çështjeve etike që lidhen me përdorimin e inteligjencës artificiale në përkthim, si autorësia, përgjegjësia, besueshmëria dhe konfidencialiteti.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

h) Zhvillimi i një modeli të balancuar për integrimin e teknologjisë në mësimdhënien dhe praktikën e përkthimit.

**6. Didaktika e përkthimit dhe zhvillimi i kompetencës përkthimore në arsimin e lartë**

**Objektivat:**

- a) Studimi i mënyrave se si zhvillohet kompetenca përkthimore tek studentët e programeve të gjuhës gjermane, përkthimit dhe komunikimit ndërkulturor.
- b) Analiza e metodave bashkëkohore të mësimdhënies së përkthimit në arsimin e lartë.
- c) Hulumtimi i rolit të ushtrimeve praktike, analizës së gabimeve, punës me korpuse, projekteve përkthimore dhe reflektimit kritik në formimin e përkthyesve.
- d) Evidentimi i vështirësive që hasin studentët gjatë përkthimit të teksteve letrare, juridike, akademike dhe të specializuara.
- e) Studimi i lidhjes midis kompetencës gjuhësore, kulturore, tekstuale, terminologjike dhe teknologjike në procesin e përkthimit.
- f) Analiza e formave të vlerësimit të përkthimit në kontekstin universitar, duke përfshirë rubrikat, portofolin, vetëvlerësimin dhe vlerësimin bashkëpunues.
- g) Hulumtimi i rolit të mësimdhënësit si udhëheqës, mentor dhe ndërmjetës në zhvillimin e kompetencës përkthimore.

**Projektet kërkimore për departamentet e tjera:**

**1. Përkthimi (Ripërkthimi)letrar**

**Objektivat:**

- a. Të analizohen përkthimet e veprave letrare (prozë, poezi, dramë, teatër, letërsi për fëmijë) në planin kritik, didaktik dhe teorik.
- b. Të studiohen korelacionet e dukurive leksikore, gramatikore dhe stilistikore me qëllimin për të krijuar një metodë komplekse përkthimi, e cila do të merrte parasysh tri elementët kryesorë të gjuhës: leksikon, gramatikën dhe stilin.
- c. Të analizohet marrëdhënia gjuhë/kulturë dhe të përcaktohen strategjitë përkthimore që përdoren për përkthimin e elementëve kulturore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- d. Të vlerësohet cilësia e përkthimit nisur nga qasja e orientuar drejt gjuhës burimore ose drejt gjuhës mbërritëse.
- e. Të argumentohet dhe motivohet mundësia dhe domosdoshmëria e ripërkthimit të veprave letrare.

2. Përkthimi tekniko-shkencor

**Objektivat:**

- a. Studimi i specifikave leksikore, semantike dhe morfo-sintaksore të teksteve tekniko-shkencore nën këndvështrimin e përkthimit.
- b. Evidentimi dhe teorizimi i problematikave përkthimore terminologjike në bazë të kompetencës dygjuhësore dhe tematike të përkthyesit.
- c. Përkthimi i terminologjisë përkatëse nën objektivin e krijimit të glosarëve dygjuhësh.

3. Përkthimi multimedial

**Objektivat:**

- a. Të ndihmojë në evidentimin e karakteristikave dhe problematikave që lidhen me përkthimin multimedial dhe specialitetet e ndryshme si: dublimi, titrimi, përshtatjet për kinemanë dhe televizionin, përkthimi për dispozitivat e lëvizshëm, përkthimi (apo lokalizimi) për software-t/sitet web/videolajrat etj.
- b. Të nxisë aftësitë hulumtuese dhe analitike të studiuesve të rinj për të hulumtuar problematikën dhe debatet në lidhje me çështje të ndryshme që i përkasin përkthimit multimedial dhe vështirësitë e punës së përkthyesit.
- c. Të rrisë aftësitë e stafit akademik për të udhëhequr projekte në këtë drejtim/fushë.
- d. Të kontribuojë në aftësitë analitike dhe krahasimore të doktorantëve, dhe në dhënien e sugjerimeve konkrete për kapërcimin e vështirësive që lidhen me këtë lloj përkthimi.

4. Didaktika e përkthimit dhe interpretimit

**Objektivat:**

- a. Aspekte studimore mbi pedagogjinë e përkthimit dhe interpretimit profesional në universitet.
- b. Metoda, qasje dhe instrumenta të përdorura në analizën e praktikës përkthimore dhe korpuseve të veçantë të interpretimit.
- c. Aspekte studimore mbi deontologjinë e profesionit të përkthyesit dhe interpretit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

5. Kërkimi shkencor në përkthim dhe interpretim

**Objektivat:**

- a. Të shqyrtohen çështje që lidhen me anën konjitive të ushtrimit të profesionit (mënyra si funksionon truri i përkthyesit dhe i interpretit, kujtesa e interpretit gjatë interpretimit konsektiv dhe simultan).
  - b. Të shqyrtohet sjellja e interpretit gjatë ushtrimit të veprimtarisë (teknika e marrjes së shënimeve, menaxhimi i kohës së kufizuar, kontrollimi i stresit, kontakti visual me pjesëmarrësit e tjerë etj.).
  - c. Të studiohen kompetencat gjuhësore, ekstragjuhësore, transferuese, instrumentale, strategjike që duhet të ketë përkthyesi dhe interpreti, si dhe çështje të etikës profesionale.
6. Kontributi i studiuesve shqiptarë në studimet përkthimore dhe të interpretimit në shekujt XX dhe XXI

**Objektivat:**

- a. Të ndihmojë në evidentimin e kontributit të dhënë nga gjuhëtarët, përkthyesit, studiuesit shqiptarë në studimet mbi përkthimin dhe interpretimin, njohjen e vështirësive me të cilat janë ndeshur dhe vazhdojnë të ndeshen studiuesit shqiptarë.
- b. Të nxisë aftësitë hulumtuese dhe analitike të studiuesve të rinj duke u bazuar në shembuj konkretë kërkimesh dhe studimesh në gjuhën shqipe.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**NËNFUSHA E KËRKIMIT: “LETËRSIA BOTËRORE MODERNE DHE POSTMODERNE”**

**✓ DREJTIMI KËRKIMOR : “LETËRSI AMERIKANE”, “LETËRSI ANGLEZE”**

➤ **Projektet kërkimore për Departamentin e gjuhës Angleze:**

1. Letërsia moderne dhe postmoderne amerikane dhe shumësia e drejtimeve të saj në epokën bashkëkohore

**Objektivat:**

- a) T’u mundësojë studentëve të hulumtonte kontekstet kulturore, sociale dhe politike të një periudhe të caktuar historike, si edhe pasqyrimin e tyre në disa prej veprave letrare më përfaqësuese.
- b) T’i aftësojë studentët të përdorin disa prej qasjeve bashkëkohore, veçanërisht të asaj krahasuese, në studimin e letërsisë amerikane.
- c) T’u mundësojë studentëve të hulumtone aspektet estetike dhe shumë etnike të procesit letrar modern, pasmodern dhe bashkëkohor në SHBA.

2. Letërsia moderne dhe postmoderne britanike dhe shumësia e drejtimeve të saj në epokën bashkëkohore

**Objektivat:**

- a) T’u mundësojë studentëve të hulumtonte kontekstet kulturore, sociale dhe politike të një periudhe të caktuar historike, si edhe pasqyrimin e tyre në disa prej veprave letrare më përfaqësuese.
- b) T’i aftësojë studentët të përdorin disa prej qasjeve bashkëkohore, veçanërisht të asaj krahasuese, në studimin e letërsisë britanike.
- c) T’u mundësojë studentëve të hulumtone aspektet estetike dhe shumë etnike të procesit letrar modern, pasmodern dhe bashkëkohor në Mbretërinë e Bashkuar.

**✓ DREJTIMI KËRKIMOR: “LETËRSI FRËNGE”**

➤ **Projektet kërkimore Departamenti i gjuhës Frënge:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

1. Studimi i zhvillimeve letrare dhe autorëve më të spikatur të shekullit XX dhe XXI në sfondin e Francës kulturore artistike e sociale përmes një qasjeje komparatiste.

**Objektivat:**

- a. Studimi i produktit letrar dhe shkollave e prirjeve estetike sipas toposit apo periodizimit kronologjik: letërsia e fillimshekullit XX, letërsia e luftës dhe pasluftës, Romani i Ri, letërsia e viteve '80, letërsia dhe ndikimi i shkencave humane.
- b. Analiza dhe interpretimi i veprave letrare në sfondin e zhvillimeve sociale, kulturore dhe artistike, analiza e veprave të autorëve nga optika krahasimore për të specifikuar prirjet e njëjta apo diferencat midis shkollave letrare dhe individualiteteve krijuese me qëllim specifikimin e prirjeve estetike dhe poetikës së shekullit.
- c. Studime të letërsisë së fundshekullit XX dhe fillimshekullit XXI për të evidentuar prirjet e reja në kapërcyell të shekullit XX, ndryshimet që pasuan rënien e ideologjive dhe lindja e një poetike të re të shkrimit letrar të shumëllojshëm e jashtë grupimeve e shkollave. Analiza e produkteve të reja letrare, konkluzionet për të shpjeguar fundin e një epoke letrare dhe prirjet e reja të shekullit XXI.
- d. Studime të specializuara e të thelluara për të shpjeguar lidhjet e letërsisë moderne dhe postmoderne me realitete sociale e kulturore, lidhjet me artet e tjera, ndikimet e ndërsjella që mund të kontribuojnë në studime transversale të specialistëve të arteve, sociologëve apo kritikëve jo vetëm të letërsisë por edhe arteve.

2. Realitete letrare në Francën politike, sociale, kulturore e artistike të shekullit XX dhe të fillim shekullit të XXI

**Objektivat:**

- a. Studimi dhe hulumtimi i realiteteve letrare në lidhje me elemente të civilizimit për të shpjeguar lidhjet dhe ndikimet e ndërsjella midis produktit letrar dhe zhvillimeve politiko sociale e artistike.
- b. Studimi i veprave letrare jo vetëm sipas ligjshmërive të brendshme imanente të letërsisë por edhe si produkt i zhvillimeve sociale politike e kulturore artistike të një epoke.
- c. Evidentimi i lidhjeve të ngushta midis realiteteve letrare dhe zhvillimeve civilizuese të një kombi.
- d. Ngritja e paraleleve midis sistemeve të ideve dhe teorive letrare, ideologjive dhe produkteve letrare, për të shpjeguar ndikimin e frakturave të forta sociale (luftëra, revolucione, lëvizje kulturore, lëvizje emancipuese sociale...) në lindjen dhe lulëzimin e shkollave të rëndësishme letrare ; modifikimi i shijeve dhe tendencave letrare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- e. Studimi i zhvillimeve letrare në fillimshkullin XXI në lidhje me një realitet të ri social: rënien e ideologjive dhe të ligjërimeve të mëdha të historisë. Forcimi i lidhjeve dhe ndikimi gjithnjë e më i fortë i shkencave humane në letërsinë franceze. Lindja e një poetike të re plurale me interes të veçantë për çështjet e kujtesës, të historisë dhe etnologjisë së epokës aktuale pasindustriale.

✓ **DREJTIMI KËRKIMOR: “LETËRSI GREKE”**

➤ **Projekti kërkimor, Departamenti i gjuhës Greke:**

1. Ndjeshmëria poetike e shkrimtareve femra në Greqinë pas viteve 1930

**Objektivat:**

- Kategorizimi i letërsisë femërore në Greqi sipas periudhave më të rëndësishme historike, përfshi modernizmin, periudhën pas viteve 1945, periudhën e Diktaturës në Greqi (1974), letërsinë bashkëkohore.
- Analiza dhe interpretimi i veprave letrare të përzgjedhura sipas tematikave dhe tendencave të ndryshme letrare të kohës (përfshi modernizmin, simbolizimin, surrealizmin, postmodernizmin, etj.)
- Evidentimi i ndjeshmërisë poetike së shkrimtareve femra në Greqi nëpërmjet krahasimit me modelet më të njohura të letërsisë evropiane dhe botërore, në një këndvështrim krahasues.
- Sa të njohura janë këto poete femra për lexuesin shqiptar? Cilat autore janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe a është përcjellë ndjeshmëria e tyre poetike me të njëjtin tonalitet në gjuhën shqipe?

✓ **DREJTIMI KËRKIMOR: “LETËRSI ITALIANE”**

➤ **Projekti kërkimor i Departamentit të gjuhës Italiane:**

Grupi mësimor-kërkimor i angazhuar: Grupi mësimor-kërkimor i Letërsisë

1. Letërsia italiane dhe feja/historia/gjeografia/sociologjia/pushteti....

**Objektivat:**

- a. Një studim të thelluar të veprave të shkruara.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- b. Njohje e zhanreve të ndryshme letrare, e çështjeve kryesore estetike, politike, fetare dhe sociale që kanë ndikuar dhe kontribuar në formësimin e letërsisë së të gjitha kohëve dhe kulturave.
  - c. Një studim i njerëzve dhe mënyrës sesi ata shprehin idetë që janë të rëndësishme për ta, një mënyrë për të kuptuar të tjerët në përgjithësi dhe për të përmirësuar aftësinë e studiuesit për të ndërvepruar brenda komunitetit.
  - d. Rritje e njohurive dhe përmirësim i kuptimit të letërsisë sipas qasjeve të saj të ndryshme kulturore.
  - e. Zhvillimi i kompetencave komunikative shumëgjuhësore e ndërkulturore në gjuhë të huaj.
  - f. Njohje e studiuesit dhe e kritikës letrare shqiptare me letërsinë e shkruar në gjuhën italiane nga shkrimtarë shqiptarë që botojnë në gjuhën italiane përmes krijimit të një panorame të plotë të botimeve përkatëse.
  - g. Qasje vepruese për përdorimin e letërsisë në mësimin e gjuhës së huaj dhe në fusha të tjera si gazetari, marrëdhënie me publikun, botim dhe komunikim, në fushën historike dhe/ose kulturore ose edhe në firmat konsulente.
2. Letërsia italiane në dialog me kulturën, historinë, fenë, pushtetin, kujtesën dhe ndërkulturalitetin : qasje teorike, krahasuese dhe didaktike

**Objektivat:**

- a. Të analizohen marrëdhëniet ndërmjet letërsisë dhe historisë, fesë, pushtetit dhe kujtesës.
- b. Të analizohen marrëdhëniet ndërmjet letërsisë, medias dhe kinemasë.
- c. Të nxitet përdorimi i metodologjive ndërdisiplinore dhe krahasuese në kërkimin shkencor.
- d. Të studiohen narrativat e migracionit, identitetit dhe ndërkulturalitetit.
- e. Të shqyrtohet funksioni kulturor dhe social i letërsisë në kontekstin evropian dhe global.
- f. Të zhvillohen qasje didaktike për përdorimin e teksteve autentike në mësimdhënien e gjuhës, kulturës dhe letërsisë.
- g. Të zhvillohet një studim teorik dhe krahasues mbi letërsinë italiane moderne dhe bashkëkohore.
- h. Të realizohet integrimi i mediave të tjera (kinema, arkiva, muze, dokumentarë, media digjitale) në interpretimin dhe didaktikën e letërsisë.
- i. Të nxitet krahasimi i autorëve dhe teksteve nga kultura të ndryshme mbi tema të përbashkëta ndërkulturore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- j. Të nxitet përdorimi i materialeve autentike dhe edukimi ndërkulturor në mësimdhënie.
- k. Të promovohet dialogu ndërkulturor përmes letërsisë.
- l. Të analizohen metodologjitë bashkëkohore të didaktikës së letërsisë.

3. Letërsia italiane dhe letërsia arbëreshe, qasje krahasuese

**Objektivat:**

- a. Të bëhet analizë filologjike dhe tekstuale e veprave të marra në studim.
- b. Të studiohen burimet historike dhe letrare, të analizohen personazhet dhe tematika kryesore të veprave.
- c. Të kontekstualizohen veprat në kuadrin e marrëdhënieve kulturore ndërmjet komuniteteve arbëreshe dhe Shqipërisë.